



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 173

Tiranë – E mërkurë, 18 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11381, datë 10.12.2019	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 13211
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 18.12.2019	Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar..... 13211
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 35, datë 12.12.2019	Për përcaktimin e rregullave dhe të standardeve mbi raportimin dhe monitorimin e ecurisë financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat nga autoritetet kontraktuese 13212
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 556, datë 17.12.2019	Për caktimin e personave të autorizuar që do të përdorin portalin qeveritar <i>e-Albania</i> për shërbimet <i>on-line</i> , prej datës 1.1.2020..... 13218
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 58, datë 5.11.2019	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 22, datë 30.3.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetës-Kanalizime Rrogozhinë”..... 13219
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 59, datë 25.11.2019	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 36, datë 6.9.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetës-Kanalizime Cërrik”..... 13220

**DEKRET****Nr. 11381, datë 10.12.2019****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Petrit Zambak Saraili
2. Arsen Agim Mevlani
3. Nikë Sokol Pjetra
4. Manjola Zarif Konjuhi
5. Arsilda Arsen Proko
6. Oliver Ardit Hamzai
7. Henry Ardit Hamzai
8. Elona Rrahman Bregaj (Çerma)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

AKT NORMATIV**Nr. 10, datë 18.12.2019****PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8438,
DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 8/1, pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme. Mënyra e përfitimit për kategoritë sipas kësaj pike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Pas nenit 8/1 shtohet neni 8/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 8/2

1. Për të përfituar nga përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat, personat përfitues sipas pikës 1/1, të nenit 8/1, të këtij ligji, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë përfitues të pensionit sipas legjislacionit në fuqi në vendet ku e kanë përfituar atë;

b) të jenë pajisur me leje qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) të mos kenë qenë ndonjëherë të dënuar në shtetin e vet apo në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet tjetër për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie;

ç) të kenë marrë përgjigje pozitive nga struktura përgjegjëse administrative për përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale të përfitimit të pensionit. Kërkesa e palëve të interesuara duhet të shoqërohet me dokumentet provuese për parashikimet e shkronjave “a”, “b” e “c”, të kësaj pike, si dhe një kopje të pasaportës së tyre të lëshuar nga shteti ku kanë vendbanimin e përhershëm.

2. Strukturat e organeve tatimore janë përgjegjëse dhe garantojnë trajtim të barabartë të çdo kërkesë të depozituar nga palët e interesuara për të qenë përfitues nga zbatimi i këtij ligji. Në rast përgjigjeje negative ose të mungesës së përgjigjes nga struktura përgjegjëse administrative, brenda afateve ligjore të parashikuara, palës së interesuar i



lind e drejta për ankimim administrativ, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Personat përfitues sipas pikës 1/1, të nenit 8/1, të këtij ligji, humbasin të drejtën e përjashtimit nga tatimi mbi të ardhurat në kushtet e mosripërtëritjes së lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, kur për këtë nuk është bërë kërkesë në strukturat përgjegjëse deri 6 (gjashtë) muaj nga data e mbarimit të lejes. Në rast përgjigjeje negative ose të mungesës së përgjigjes nga struktura përgjegjëse administrative, brenda afateve ligjore të parashikuara, palës së interesuar i lind e drejta për ankimim administrativ, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.”.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 35, datë 12.12.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE TË STANDARDEVE MBI
RAPORTIMIN DHE MONITORIMIN E
ECURISË FINANCIARE DHE
JOFINANCIARE TË KONTRATAVE TË
KONCESIONIT/PARTNERITETIT
PUBLIK PRIVAT NGA AUTORITETET
KONTRAKTUESE**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 10, të ligjit nr. 125, datë 10.7.2013, “Për koncesionet/partneritetin publik privat”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Përcaktimin e rregullave dhe të standardeve mbi raportimin dhe monitorimin e ecurisë së kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat nga autoritetet kontraktuese.

QËLLIMI

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave standarde, procedurave, afateve që duhet të ndiqen në procesin e raportimit dhe të

monitorimit të ecurisë dhe të performancës financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/PPP, nga të gjitha autoritetet kontraktuese. Ky udhëzim është në harmoni me kuadrin ligjor për koncesionet/partneritetin publik privat dhe me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

I. TË PËRGJITHSHME

a) Objekt i raportimit dhe i monitorimit nga ana e autoriteteve kontraktuese që zbatojnë dhe monitorojnë kontrata koncesioni/PPP, fushë të përgjegjësisë së tyre, janë të gjitha kontratat e koncesioni/partneritetit publik privat të lidhura në Republikën e Shqipërisë, të cilat janë të publikuara në Regjistrin Elektronik të Koncesionit/PPP.

b) Ky është një udhëzim standard në të cilin përcaktohen: forma, përmbajtja dhe afatet e raporteve periodike të monitorimit (RPM) të kontratave të koncesionit/PPP nga autoritetet kontraktuese, si dhe përmbajtja e raportit vjetor të përmbledhur të të gjitha këtyre kontratave të koncesioneve/PPP.

II. PROCEDURAT PËR PROCESIN E MONITORIMIT

Mbledhja e raporteve të monitorimit të zbatimit të kontratave të koncesionit/PPP

a) Procesi formal i raportimit mbi ecurinë e monitorimit të kontratave koncesionare/PPP kërkon përgatitjen e të paktën 4 raporteve periodike të monitorimit në vit për ecurinë dhe performancën financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/PPP, si dhe të një raportit vjetor monitorimi mbi ecurinë e termave të kontratës së koncesionit/PPP.

b) Format i raportimit të raporteve të përmbledhura të monitorimit do të bëhet sipas¹:

- aneksit nr. 1, “Profil i projektit”;
- aneksi nr. 2, “Ecuria vjetore e termave të kontratës së koncesionit/PPP”;
- aneksi nr. 3, “Ecuria tremujore e termave të kontratës së koncesionit/PPP”;
- aneksit nr. 4, “Monitorimi periodik i risqeve për kontratën e koncesionit/PPP”.

c) Të dhënat mbi ecurinë e kontratave të koncesionit/PPP raportohen nga autoritetet

¹ Anekset nr. 1, 2, 3, 4 janë hartuar dhe sugjeruar nga ekspertët e Bankës Botërore me qëllim thjeshtëzimin e procesit të raportimit nga autoritetet kontraktuese.



kontraktuese të cilat menaxhojnë dhe monitorojnë këto kontrata.

2. Afatet për dorëzimin e raporteve të monitorimit

Autoritetet kontraktore raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për financat, lidhur me ecurinë dhe performancën financiare dhe jofinanciare (arritja e treguesve/*output*-eve) të secilës prej kontratave koncesionare të tyre. Ky informacion dërgohet me shkrim dhe në rrugë elektronike përkatësisht pranë:

a) Drejtorisë përgjegjëse për Koncesionet/PPP, si vijon:

Brenda datës 10 të muajit pasardhës të periudhës tremujore në monitorim, dërgohet raportimi sipas:

- aneksit nr. 1, “Profil i projektit”;
- aneksi nr. 2, “Ecuria vjetore e termave të kontratës së koncesionit/PPP”;
- aneksi nr. 3, “Ecuria tremujore e termave të kontratës së koncesionit/PPP”;
- aneksi nr. 4, “Monitorimi periodik i risqeve për kontratën e koncesionit/PPP”;

bashkëlidhur këtij udhëzimi, si edhe sa herë që kërkohet nga ministria përgjegjëse për financat, lidhur me periudha të caktuara apo specifika eventuale.

b) Sektorit të Menaxhimit të Risqeve Buxhetore:

Informacion sipas udhëzimeve përkatëse për zbatimin e buxhetit.

c) Informacione të tjera

Drejtoria përgjegjëse për koncesionet mund të kërkojë informacion lidhur me procesin e monitorimit sa herë është e nevojshme pranë strukturave të tjera në ministrinë përgjegjëse për financat.

Bazuar në informacionet e germave “a”, “b” dhe “c”, drejtoria përgjegjëse për koncesionet/PPP, në ministrinë përgjegjëse për financat, koordinon punën me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor dhe Sektorin e Monitorimit të Risqeve Buxhetore dhe përgatit raportin e vjetor të përmbledhur të vitit paraardhës mbi ecurinë e kontratave aktive të koncesionit / PPP dhe e paraqet për informacion te ministri përgjegjës për financat.

III. RAPORTI VJETOR I PËRMBLEDHUR I MONITORIMIT

Raporti vjetor i përmbledhur (RVP) është një dokument i ministrisë përgjegjëse për financat që përfshin mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të ecurisë dhe të performancës financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/PPP, i cili synon të sigurojë që risqet kryesore fiskale nga kontratat e koncesionit/PPP janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike.

Ky raport përmban elementet si më poshtë:

- Një pamje të përgjithshme të portofolit aktual të koncesioneve/PPP-ve (vlera totale e projekteve me koncesion/PPP, numrin e kontratave, statusin e projekteve dhe burimin e financimit). Gjithashtu, nëpërmjet RVP-së do të sigurohet edhe një rishikim i ndryshimeve në portofolin e PPP-ve (numrin e projekteve me ndryshime të statusit të projektit, vlerat e përditësuara të kontratave nëse ka).

- Një përshkrim të performancës së portofolit të koncesioneve/PPP (statistika mbi treguesit financiarë dhe jofinanciarë të projektit, si: statistika mbi ndërtimin, statistikat specifike të performancës së sektorit etj.). Gjithashtu, në këtë seksion do të paraqitet një përmbledhje e pagesave buxhetore të parashikuara dhe atyre të realizuara sipas PBA-së, si dhe risqet që rrjedhin nga këto kontrata koncesioni/PPP, nëse janë materializuar apo jo, impaktin në buxhetin e shtetit dhe probabilitetin që kanë për të ndodhur.

Ky raport përcillet pranë Drejtorisë përgjegjëse për Menaxhimin e Buxhetit, brenda datës 10 maj të çdo viti buxhetor dhe përbën një aneks të raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit për vitin paraardhës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

IV. TË TJERA

Bashkëlidhur këtij udhëzimi janë:

- aneksit nr. 1, “Profil i projektit”;
- aneksi nr. 2, “Ecuria vjetore e termave të kontratës së koncesionit/PPP”;
- aneksi nr. 3, “Ecuria tremujore e termave të kontratës së koncesionit/PPP”;
- aneksi nr. 4, “Monitorimi periodik i risqeve për kontratën koncesionare/PPP”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj



Udhëzime për modelin e monitorimit të koncesionit/PPP

Këto tabela duhet të plotësohen nga autoritetet kontraktuese për çdo kontratë koncesioni/PPP dhe të dorëzohen pranë MFE-së çdo 3 (tre) muaj.
Autoriteti kontraktues pritet të ketë plotësojë tabelën e monitorimit në koordinim të ngushtë me Njësinë e Zbatimit të Projektit (NJZP).
Lutemi përfshini të gjitha të dhënat aktuale/të planifikuara/të pritura gjatë gjithë periudhës së projektit.

Udhëzime për plotësimin e raportit të monitorimit të projektit

Qelizat e verdha duhet të futen me numra/tekst sipas nevojës.
Qelizat blu duhet të plotësohen me menunë rënëse (Drop-Down menu).

Pyetje dhe përgjigje (Q&A)

Profili i projektit**Si përkufizohet një projekt?**

Një projekt përfshin të gjitha kontratat dhe amendimet e saj kundrejt objektivave për ofrimin e shërbimit përmes koncesionit/PPP, por pa përfshirë kontratat e veçanta të mbikëqyrjes.
Projekti i monitoruar duhet të ndjekë përkufizimin e projektit të përdorur në bazën e të dhënave Atrako-s.

Cila është vlera e investimit të projektit?

Kjo është kostoja totale e planifikuar e të gjitha shpenzimet në lidhje me ndërtimin për projektin, pa TVSH.

Cila është kostoja totale e planifikuar e projektit për qeverinë?

Kjo është shumë e kontributeve buxhetore të planifikuara aktualisht gjatë gjithë periudhës së projektit, përfshirë TVSH-në.

Raportimet statistikore tremujore dhe vjetore**Si përkufizohet kontributi buxhetor në një projekt të caktuar?**

Raporti i monitorimit tregon kontributin e buxhetit nga viti në të cilin ka filluar pagesa e buxhetit për projektin (ose është planifikuar të fillojë).
Kontributet e planifikuara duhet t'u referohen pagesave aktuale të buxhetit të pritura nga njësia e zbatimit të projektit (kur është e mundur të koordinohet me departamentin e buxhetit të MFE-së).
Pagesat e buxhetit duhet të përfshijnë TVSH.

Si përcaktohen të ardhurat e përdoruesit?

Të ardhurat e vlerësuara të projektit duhet t'u referohen parashikimeve aktuale të të ardhurave të projektit.
Të ardhurat e projektit duhet të përfshijnë TVSH-në, kur është e aplikueshme.

Si përcaktohen treguesit e kërkesës?

Treguesi i kërkesës duhet të masë drejtimin e të ardhurave për projektin (përdoruesit/njësitë e shërbimit/etj.). Kjo duhet të bazohet në objektiva sasiorë të specifikuar në kontratë.
Shembuj.

Për projektet rrugore, treguesit e sugjeruar të kërkesës do të jenë numri i automjeteve/numri i akseve të automjeteve/të ardhurat nga Toll-i.

Për aeroportet, treguesit e sugjeruar të kërkesës do të ishin numri i pasagjerëve/ngarkesave (ton).

Për projektet e hidrocentraleve, treguesi i sugjeruar i kërkesës do të ishte kë e transmetuara në rrjetin e energjisë.

Për inceneratorët, treguesi i sugjeruar i kërkesës është sasia e mbeturinave të përpunuara (ton).

Si janë treguesit e performancës të përcaktuara?

Treguesit e performancës duhet të tregojnë cilësinë e shërbimit të ofruar. Kjo duhet të bazohet në objektiva sasiorë të specifikuar në kontratë.
Shembuj.

Për projektet rrugore, treguesit e sugjeruar të performancës mund të jenë zvogëlimi i aksidenteve trafiku, cilësia e trotuarit në rrugë etj.

Për aeroportet, treguesit e sugjeruar të performancës mund të matet nga kënaqësia e pasagjerëve, koha e pritjes, vonesa në fluturime etj.

Për inceneratorët, treguesit e sugjeruar të performancës mund të jenë efektet ndaj ndotjes së mjedisit, energjia e prodhuar etj.

Matrica e riskut**Si duhet të plotësohet matrica e rrezikut?**

Mjeti PFRAM Excel (mund të shkarkohet në internet) përfshin pyetje të hollësishe për të ndihmuar të vendosni për plotësimin e matricës së riskut në këtë model raportimi.



Aneksi 1. Profili i projektit	Përshkrimi
Data në të cilën ky aneks është përditësuar (DD/MM/YYYY)	(DD/MM/YYYY) data në të cilën ky aneks është përditësuar.
Emri i projektit	Projekti përfshin të gjitha kontratat e lidhura (duke përfshirë kontratat e veçanta të mbikëqyrjes).
Autoriteti kontraktues	Subjekti qeveritar përgjegjës (ministria e linjës/qeverisja lokale etj.), përgjegjës kryesor në procesin e monitorimit të këtij projekti koncesion/PPP.
Autoriteti kontraktues nr. 2 (n.q.s. ka)	Institucione të tjera qeveritare.
Partneri privat	Emri i SPV-së ose i strukturës tjetër të sektorit privat që bashkëpunon me qeverinë.
Vlera e investimit (shpenzimet në lidhje me ndërtimin, përfshirë TVSH-në)	Të gjitha shpenzimet që lidhen me ndërtimin (përfshirë shpenzimet siç është disenjimi) përfshirë dhe TVSH-në.
Kostoja totale e planifikuar për qeverinë (përfshirë TVSH-në)	Shuma e kontributeve vjetore të planifikuara të buxhetit, përfshirë TVSH-në.
Data e fillimit të kontratës	(DD/MM/YYYY) data e nënshkrimit të kontratës.
Kohëzgjatja (vite)	Planifikimi/ndërtimi/operim/hibrid (pjesa ndërtimore dhe pjesa operative)/joaktive.
Faza e projektit	
Përshkrimi i projektit	Çfarë sektori është? Cili është shërbimi i ofruar nga projekti koncesion/PPP?
	Çfarë asetë përfshin?
	Çfarë ndodh me asetet në fund të projektit? A do t'i transferohen qeverisë apo jo?
Përmbledhja e progresit të projektit	A është projekti në rrugën e duhur? Çfarë po shkon mirë dhe cilat janë fushat me probleme?
	Theksoni arritjet dhe pengesat?
	Theksoni nëse/si/pse faktorët deviojnë materialisht nga: i. plani në nënshkrimin e kontratës; dhe ii. plani nga raportet e mëparshme të monitorimit.
	Theksoni nëse/si/pse plani ndryshon thelbësisht nga raportet e mëparshme të monitorimit.
	A është kontrata në rinegociim? A ka çështje gjyqësore në proces?
	A ka shikueshmëri të qartë në lidhje me pagesat buxhetore?
Risqet kryesore	Përmbledhja e risqeve më të rëndësishme për projektin që mund të materializohen në të ardhmen dhe duhet të monitorohen.
	Përmbledhje e risqeve më të rëndësishme për projektin që janë materializuar tashmë.
	Shihni kategoritë e risqeve në aneksin e matricës së risqeve dhe mjetin PFRAM në internet për të ndihmuar në identifikimin e rreziqeve kryesore.



Aneksi 2: Statistika vjetore të projektit																																	
Emri i Projektit																																	
Data në të cilën aneksi është përditësuar (DD/MM/YYYY)																																	
			Njësia	Përshkrimi i rreshtit	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Financimi	Pagesa e buxhetit 1 (autoritet kontraktues 1)	Planifikuar		Pagesat cash të planifikuara nga buxheti (me TVSH)																													
		Aktuale		Pagesat cash të kryera nga buxheti (me TVSH)																													
	Pagesa e buxhetit 2 (autoriteti për kontraktues, nëse ka)	Planifikuar		Pagesat cash të planifikuara nga buxheti (me TVSH)																													
		Aktuale		Pagesat cash të kryera nga buxheti (me TVSH)																													
	Të ardhurat nga përdoruesit	Vlerësuar		Të ardhurat cash të vlerësuara (me TVSH nëse ka)																													
		Aktuale		Të ardhurat cash të mbledhura (me TVSH nëse ka)																													
Ndërtim	Progresi i ndërtimeve (% e përfunduar; fundi i periudhës)			Vendos "NA" për kontratat e shëfimit																													
Kërkesa (përdoruesit / shërbimet ofruara)	Treguesi i kërkesës 1	Vlerësuar																															
		Aktuale																															
	Treguesi i kërkesës 2	Vlerësuar																															
		Aktuale																															
	Treguesi i kërkesës 3	Vlerësuar																															
		Aktuale																															
Performanca (mëja e cilësisë së shërbimit)	Treguesi i performancës 1	I kërkuar																															
		Aktual																															
	Treguesi i performancës 2	I kërkuar																															
		Aktual																															
	Treguesi i performancës 3	I kërkuar																															
		Aktual																															



Aneksi 3: Statistikat tremujore për projektin									
Emri I Projektit									
Data në të cilën aneksi është përditësuar (DD/MM/YYYY)									
			N	Përshkrimi i rreshtit	Komenti nga Autoriteti Kontraktues	Viti Aktual			
						Q1 (Janar-Mars)	Q2 (Prill-Qershor)	Q3 (Korrik-Shtator)	Q4 (Tetor-Dhjetor)
Financimi	pagesa e buxhetit 1 (autoriteti kontraktues 1)	Plani fikuar		Pagesat cash të planifikuara nga buxheti (me TVSH)					
		Aktuale		Pagesat cash të kryera nga buxheti (me TVSH)					
	Pagesa e buxhetit 2 (autoriteti tjetër kontraktues, nëse ka)	Plani fikuar		Pagesat cash të planifikuara nga buxheti (me TVSH)					
		Aktuale		Pagesat cash të kryera nga buxheti (me TVSH)					
	Të ardhurat nga përdoruesit	Vlersuar		Të ardhurat cash të vlerësuara (me TVSH nëse ka)					
		Aktuale		Të ardhurat cash të mbledhura (me TVSH nëse ka)					
Ndërtim	Progresi i ndërtimeve (% e përfunduar; fundi i periudhës)			Vendos "NA" për kontratat e shërbimit					
Kërkesa (përdoruesit / shërbimet e ofruara)	Treguesi i kërkesës 1	Vlersuar							
		Aktuale							
	Treguesi i kërkesës 2	Vlersuar							
		Aktuale							
	Treguesi i kërkesës 3	Vlersuar							
		Aktuale							
Performanca (matja e cilësisë së shërbimit)	Treguesi i performancës 1	I kërkuar							
		Aktuale							
	Treguesi i performancës 2	I kërkuar							
		Aktuale							
	Treguesi i performancës 3	I kërkuar							
		Aktuale							



URDHËR

Nr. 556, datë 17.12.2019

**PËR CAKTIMIN E PERSONAVE TË
AUTORIZUAR QË DO TË PËRDORIN
PORTALIN QEVERTAR *E-ALBANIA*
PËR SHËRBIMET *ON-LINE*,
PREJ DATËS 1.1.2020**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 7, pika 2 e ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, si dhe në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 158, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm *on-line* nga data 1.1.2020”,

URDHËROJ:

1. Të gjitha dokumentet administrative që shërbejnë si dokumentacion shoqërues për marrjen e shërbimeve elektronike në portalin *e-Albania*, duke nisur nga data 1.1.2020 do të ofrohen dhe do të shkëmbehen vetëm elektronikisht përmes Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik.

2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, si dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë së përcaktuar në këtë urdhër, të cilët lëshojnë dokumente që janë shoqëruese për aplikimet që do të jenë vetëm *on-line*, të aplikojnë menjëherë për t’u pajisur me nënshkrim elektronik, nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*.

3. Paraqitja e kërkesave për marrjen e shërbimeve *on-line*, nëpërmjet sistemit *on-line*, duke filluar nga data 1.1.2020 bëhet vetëm për shërbimet e listuar në aneksin nr. 1, të këtij urdhri, i cili është pjesë përbërëse e tij.

4. Personat që përdorin Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve të Shërbimeve *on-line*, me qëllim kërkimin dhe/ose ofrimin e dokumenteve shoqëruese, të dokumenteve me nënshkrimin

elektronik, autorizohen nga titullarët e institucioneve të varësisë.

5. Ngarkohen titullarët institucioneve të varësisë, të përcaktuar në këtë urdhër, që brenda datës 20.12.2019, të përcaktojnë dhe të dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë emrat e personave të autorizuar, sipas pikës 4, të këtij urdhri.

6. Ngarkohet Sektori i Teknologjisë Informacionit në Ministrinë e Drejtësisë, që në bashkëpunim me AKSHI-n, të trajnojë personat e autorizuar mbi procedurat e ofrimit të shërbimeve dhe aksesimit në Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik.

7. Të gjitha institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij urdhri mundësojnë informimin dhe sensibilizimin e publikut mbi aplikimet e shërbimeve që do të ofrohen vetëm në portalin qeveritar *e-Albania*.

8. Ngarkohen titullarët e drejtorive brenda aparatit të Ministrisë së Drejtësisë dhe titullarët e institucioneve të varësisë, që brenda datës 24.12.2019 të informojnë pranë adresës elektronike sekretariasp@drejtesia.gov.al, mbi konfirmimet për aplikimet e kryera në portalin qeveritar *e-Albania*.

9. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, që brenda datës 27.12.2019, të raportojë pranë ministrit të Drejtësisë, mbi aplikimet e kryera.

10. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Agjencia e Trajtimit të Pronave, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, si dhe Qendra e Botimeve Zyrtare, për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjona (Saliu)



SHËRBIMET QË MUND TË OFROHEN VETËM ON-LINE PREJ DATËS 1.1.2020

Nr.	Institucioni	Titulli	Shërbimet do të merren në:	Afati për kalimin VETËM on-line
1	Ministria e Drejtësisë	Aplikim për ekspert gjykatë	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
2	Ministria e Drejtësisë	Vërtetim si ekspert gjykatë	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
3	Ministria e Drejtësisë	Vlerësim i ekspertëve në gjykata	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
4	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Vërtetim i hyrje-daljes nga burgu (dënimi)	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
5	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Vërtetim i periudhës së burgut	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
6	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti)	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
7	Agjencia e Trajtim të Pronave	Ankesë dhe trajtim i dosjes me specialistin përkatës pranë ATP-së	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
8	Agjencia e Trajtim të Pronave	Aplikim për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
9	Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit	Aplikim për licencimin e administratorëve të falimentit	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
10	Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit	Aplikim për rinovimin e licencës së administratorëve të falimentit	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
11	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaarimit	Aplikim për vërtetimin e detyrimeve përmbaarimore	Portalin qeveritar <i>e-Albania</i>	1 janar 2020
12	Qendra e Botimeve Zyrtare	Shitje on-line të botimeve të QBZ-së	Faqe <i>web</i> e QBZ-së	1 janar 2020
13	Qendra e Botimeve Zyrtare	Abonimet vjetore mbi botimet e QBZ-së	Faqe <i>web</i> e QBZ-së	1 janar 2020

VENDIM
Nr. 58, datë 5.11.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 22, DATË 30.3.2018, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME RROGOZHINË”

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe

largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 5.11.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: Mbi miratimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 22, datë 30.3.2018, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë (UK Rrogozhinë), me shkresën nr. 76 prot., datë 6.10.2019, me lëndë: Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Rrogozhinë, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor



dhe të drejtuesit teknik, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Rrogozhinë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Rrogozhinë me vendimin nr. 22, datë 30.3.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe të largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Rrogozhinë sh.a., z. Skënder Dedej, ka mbaruar studimet e larta në Inxhinieri mekanike në vitin 1996, ka shërbyer edhe më parë si drejtues ligjor i kësaj shoqërie nga viti 1990–1991 dhe nga viti 1998–2006.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmblotjen nga ana e UK Rrogozhinë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë, sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Rrogozhinë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. 22, datë 30.3.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor: Skënder Dedej;

Drejtues teknik: Skënder Dedej.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 59, datë 25.11.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 36, DATË 6.9.2017, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME CËRRIK”

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe të rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 25.11.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: Mbi miratimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 36, datë 6.9.2017, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Cërrik’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Cërrik (UK Cërrik), me shkresën nr. 428 prot., datë 19.11.2019, të Entit Rregullator të ujit (ERRU), ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), dokumentacionin për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Cërrik për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.



3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Cërrik me vendimin nr. 36, datë 6.9.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Cërrik”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe të largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Cërrik sh.a. z. Eneo Taçaj, ka mbaruar studimet e larta në Ekonomi, dega Ekonomia dhe e drejta, si dhe master për të drejtën civile.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Cërrik sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë,

eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Cërrik është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR nr. 36, datë 6.9.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Cërrik” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor: z. Eneo Taçaj.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndrëçim Shani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë